



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

## UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.15, datë 26.01.2022

### (Mbi rregullshmërinë e mbajtjes dhe depozitimit të akteve procedurale dhe regjistrave të prokurorisë)

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 43 dhe 46 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.7905 datë 27.04.1995 “Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, infomimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” si dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan;

### KONSTATOJ:

Zyra e Regjistrimit të kësaj prokurorie ka informuar Drejtuesin e Prokurorisë mbi disa situata problematike të krijuar nga prokurorë të caktuar në lidhje me rregullshmërinë e mbajtjes, përpilimit dhe depozitimit të akteve procedurale, të cilat për pasojë kanë krijuar problematika në mbajtjen dhe evidentimin e saktë të të dhënave statistikore si dhe në rregullshmërinë e lëshimit të vërtetimeve nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Sa më sipër me qëllim ushtrimin e funksionit të drejtuesit të prokurorisë, forcimin e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe

punonjësve administrativ, zgjidhjen e problematikave të hasura deri më sot si dhe përcaktimin e përgjegjësive personale të personave që veprojnë në keqbesim në kundërshtim me ligjin ;

### UDHËZOJ :

1. Sekretaret e Zyrës së Regjistrimit në prokurori ndalohen të regjistrojnë procedim penal dhe procedim pasuror nëse nga prokurori i çështjes nuk është përpiluar dhe dorëzuar pranë kësaj zyre urdhëri për regjistrimin e procedimit penal ose procedimit pasuror. Vula që dokumenton numrin dhe datën e procedimit penal vendoset detyrimisht dhe vetëm mbi aktin procedural urdhër për regjistrimin e procedimit penal/procedimit pasuror. Më pas Zyra e Regjistrimit bën shënimet përkatëse të regjistrat fizik dhe elektronik.
2. Çdo prokuror i kësaj prokurorie depoziton menjëherë në Zyrën e Regjistrimit një kopje të urdhërit të regjistrimit të emrit të personit nën hetim, në ato raste kur urdhëri i regjistrimit të emrit të personit nën hetim nuk është i njëjtë me urdhërin e regjistrimit të procedimit penal. Më pas Zyra e Regjistrimit bën shënimet përkatëse të regjistrat fizik dhe elektronik.
3. Çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim më sa më sipër përbën shkak për përgjegjësi disiplinore.
4. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët e kësaj prokurorie, kancelarja dhe sekretaret e Zyrës së Regjistrimit. Një kopje e këtij urdhëri i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti TI-së me kryerjen e njoftimit.
5. Ky udhëzim hyn në fuqi sot më datë 26.01.2022 dhe publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

**DREJTUES I PROKURORISË**

**Kreshnik AJAZI**